



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .05.2025

**MBLEDHJA Nr. 22,
Datë 23.05.2025, ora 11:00
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 23.05.2025, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 22 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “SPV BLUE 2” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “5GX ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës siguroese) të aseteve të paluajtshme të saj.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “DELIU 3D” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “G.S.K” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “GREENNAT PARK SOLAR BALLSH” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
7. Mbi kërkesën e shoqërisë “INFO-TELECOM” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.
8. Mbi një ndryshim në vendimin nr. 85/2025 të shoqërisë “ALBESP TRADING & CONSULTING” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.
9. Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e planit 5 – vjeçar të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike të shoqërisë OSSH sh.a. për periudhën 2023 – 2027.

10. Mbi llogaritjen e pagesave rregullatore për vitin 2025.

11. Çështje të tjera.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI